

Nr. 02. prot
dt. 04.02.2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT DHE INVESTIMEVE

VENDIM I BORDIT DREJTUES

Nr. 2, datë 04.02.2011

Bordi Drejtues i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), i mbledhur sot më 4.2.2011, pasi shqyrtoi projektstatutin e AIDA-s në zbatim të nenit 12/c, të ligjit nr.10 303, datë 15.7.2011, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve",

VENDOSI:

Miratimin e statutit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SALI BERISHA

KRYETAR I BORDIT DREJTUES

STATUTI
I AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Të përgjithshme

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr.10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve" dhe të këtij statuti.

Ky statut është dokumenti bazë, që rregullon veprimtarinë e kësaj Agjencie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Me termin "Ligj" në këtë statut do ti referohemi ligjit nr. 10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve".

Neni 2

Statusi juridik

Agjencia është person juridik, publik, buxhetor dhe drejtohet nga Bordi Drejtues.

Neni 3

Emërtimi i shkurtuar

Emërtimi i shkurtuar i Agjencisë është "AIDA".

Neni 4

Selia

Selia e Agjencisë ndodhet në Tiranë në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, P. Shallvare.

CF

Neni 5

Stema dhe vula zyrtare

Agjencia identifikohet me stemën dhe vulën e saj zyrtare.

Stema e Agjencisë përbëhet nga Stema e Republikës së Shqipërisë dhe shënimi “Republika e Shqipërisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe duhet të figurojë në të gjitha dokumentet, materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare të saj.

Përmbajtja e vulës është: Republika e Shqipërisë. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

Vula e Agjencisë ka formën dhe elementet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar për vulat zyrtare dhe shënimin identifikues “Republika e Shqipërisë. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve”.

KREU II

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 6

Veprimtaria e Agjencisë

Veprimtaria e Agjencisë përqendrohet, në këto drejtime:

- a) lehtësimi dhe mbështetja e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë,
- b) rritja e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të vogla e të mesme,
- c) nxitja dhe ndihma ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve.

Agjencia ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme për zhvillimin e sektorit privat dhe për përmirësimin e klimës së biznesit, duke ndjekur dhe ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, falë ndërmjetësimit dhe bashkëpunimit me subjektet tregtare të huaj dhe me organet shtetërore.

Neni 7

Nxitja e investimeve

Agjencia, për tërheqjen dhe rritjen e investimeve në Republikën e Shqipërisë:

- a) zbaton politikat e Qeverisë Shqiptare në lidhje me promovimin e investimeve;

ef

- b) harton dhe propozon masa mbështetëse që synojnë realizimin e suksesshëm të këtyre politikave për promovimin e investimeve;
- c) identifikon dhe promovon mundësitë e investimeve në Shqipëri;
- d) ofron asistencë dhe shërbime për tërheqjen e investimeve të drejtpërdrejta;
- e) zhvillon veprimtari në funksion të promovimit të imazhit të Shqipërisë, të ndërmarrjeve dhe produkteve shqiptare, si dhe të vetë Agjencisë në nivel ndërkombëtar;
- f) përgatit, zhvillon dhe zbaton strategjitë dhe dokumentet e politikave 3-vjeçare për promovimin e investimeve
- g) përgatit dhe zbaton planin vjetor të veprimit e të marketingut, ku përcaktohen grupet e interesit, të cilëve u drejtohet, sipas sektorëve dhe zonave gjeografike të interesit;
- h) reklamon shembujt e suksesshëm të investimeve të huaja direkte me synim krijimin e një opinioni të favorshëm për përmirësimin e klimës së biznesit;
- i) ndërton dhe mban një bazë të dhënash, me informacionet për investitorët e huaj dhe investimet;
- j) publikon të dhënat zyrtare për investimet e huaja;
- k) ofron ekspertizë për realizimin e investimeve, për investitorët, subjektet tregtare dhe organet shtetërore;
- l) ndërmjetëson në marrëdhëniet ndërmjet investitorëve dhe organeve shtetërore qendrore ose vendore.

Neni 8

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Agjencia, për sa i përket ndihmës ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme:

- a) zbaton politikat Qeverisë Shqipëtare në lidhje me fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- b) ndihmon në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive të Qeverisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duke hartuar, zhvilluar dhe koordinuar programe ose projekte për mundësimin e tyre;
- c) zhvillon dhe zbaton strategjinë tre vjeçare për fuqizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

cg

Neni 9

Rinovimi dhe Përmirësimi teknologjik

Agjencia synon rinovimin e dhe përmirësimin teknologjik të bizneseve, dhe për këtë qëllim:

- a) ndihmon në hartimin dhe përmirësimin e strategjisë kombëtare të rinovimit dhe të përmirësimit të teknologjisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- b) harton dhe propozon rekomandime për përmirësimin e politikave në këtë fushë;
- c) luan një rol kryesor në mundësimin e kësaj strategjie, duke kryer funksionin e organit ekzekutiv, që ofron shërbime të drejtpërdrejta për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe mundëson përmirësimin e kapaciteteve në institucionet dhe agjencitë e tjera, në mënyrë që të sigurohet një funksionim efektiv i sistemit të rinovimit në vend;
- d) bën përpjekje për rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare e për zhvillimin e tyre, falë nxitjes së rinovimit, progresit teknologjik dhe shkëmbimeve të informacionit;
- e) siguron të dhëna të nevojshme për bizneset dhe mundëson përhapjen e tyre, nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti shkëmbimi të informacioneve, në të cilin publikohen studime, kërkime dhe analiza tregtare;
- f) promovon rritjen e pranisë së bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, si dhe krijimin e lidhjeve e të mundësive të bashkëpunimit me bizneset e huaja, për të ndihmuar rritjen e dimensioneve të tyre edhe në nivel ndërkombëtar;
- g) ndihmon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në shfrytëzimin e financimeve publike, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- h) nxit përmirësimin e klimës së biznesit, rritjen e kapaciteteve administruese të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duke përshpejtuar futjen e teknologjisë së informacionit e të komunikimit, si dhe përmirësimin e prodhimtarisë në nivel ndërmarrjeje.

Neni 10

Zhvillimi i eksportit

Agjencia, me qëllim zhvillimin e eksporteve:

- a) zbaton politikat qeverisëse të Shqipërisë në lidhje me zhvillimin e eksporteve

af

- b) ndihmon në hartimin dhe përmirësimin e strategjisë kombëtare të promovimit të eksporteve;
- c) harton dhe propozon rekomandime për përmirësimin e politikave si dhe identifikon, analizon dhe përlogarit faktorët që ndikojnë negativisht në eksportet e mallrave e të shërbimeve shqiptare, dhe propozon masat për uljen e ndikimit të këtyre faktorëve.
- d) promovon produktet dhe shërbimet shqiptare në tregjet ndërkombëtare, për të reklamuar dhe për të lehtësuar eksportin e produkteve "Made in Albania";
- e) mundëson gjetjen e burimeve të reja për eksport në Shqipëri, me synim rritjen e vlerës së shtuar;
- f) organizon një rrjet komunikues dhe një sistem shkëmbimi të dhënash me organizata partnere dhe specialistë, me qëllim rritjen e njohjes së tregjeve të përshtatshme për eksport;
- g) ofron shërbime mbështetëse dhe u jep asistencë bizneseve private, me qëllim rritjen e volumit të eksportit dhe të nxitjes së aftësive të marketingut për eksport;
- h) jep mbështetje financiare për shoqëritë eksportuese dhe ndërmerr veprime konkrete për lehtësimin e investimeve të destinuara për prodhim mallrash dhe shërbime për eksport;
- i) bashkëpunon me institucionet publike, financiare, organizatat e biznesit, të vendit dhe të huaja, për të krijuar një sistem shkëmbimi të dhënash, i cili lehtëson lidhjet tregtare dhe krijon mundësitë për shfrytëzimin e hapësirave të reja për shoqëritë e produktet shqiptare për eksport;
- j) organizon konferenca, ekspozita, panaire, si dhe veprimtari të tjera promovionale, me qëllim pjesëmarrjen e ndërmarrjeve shqiptare që prodhojnë mallra dhe ofrojnë shërbime, të destinuara për eksport;

Neni 11

Objektiva dhe aktivitete të lidhura

Aktivitetet e Agjencisë, do të synojnë maksimizimin e investimeve të huaja dhe të brendshëm, krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta dhe iniciativa ndihmuese për rritjen e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve në Shqipëri duke përmirësuar rinovimin e tyre dhe kapacitetet teknologjike me qëllimet e kombinuara.

Në ushtrimin e veprimtarive të saj Agjencia do të kërkojë krijimin e mundësive të punësimit, maksimizimin e vlerës së shtuar dhe përmirësimin e standarteve shqiptare të jetesës.

Objektiva dhe aktivitete të tjera të Agjencisë do të përfshijnë:

eg

- zbatimin e politikave të Qeverisë së Shqipërisë në lidhje me rinovimin e biznesit dhe të teknologjisë;
- konsolidimin e pozicionit të Agjencisë si pikë qendrore për ndërmarrjet shqiptare, eksportuesit dhe investitorët e huaj;
- hartimin dhe zbatimin e politikave mbështetëse me qëllim përmirësimin e klimës së investimeve dhe rritjen e konkurrencës ;
- nxitjen e bashkëpunimit dhe kohezionit midis organeve shtetërore dhe të aktorëve të tjerë të rëndësishëm në zhvillimin e biznesit, rinovimin e tij, përmirësimin teknologjik, zhvillimin rajonal dhe proceset promovuese.

KREU III

STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË

Neni 12

Organet Drejtuese

Organet Drejtuese të Agjencisë janë:

- a) Bordi Drejtues;
- b) Kryetari i Bordit Drejtues;
- c) Drejtori Ekzekutiv.

Neni 13

Përbërja e Bordit Drejtues

1. Bordi Drejtues i Agjencisë përbëhet nga përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të sektorit ekonomik privat.
2. Bordi Drejtues i Agjencisë kryesohet nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë dhe ka në përbërje:
 - a) Ministrin përgjegjës për ekonominë; nënkryetar
 - b) Ministrin përgjegjës për financat;
 - c) Ministrin përgjegjës për bujqësinë;
 - a) Ministrin përgjegjës për turizmin;
 - d) Ministrin përgjegjës për punët publike.

eg

3. Anëtarë të Bordit Drejtues zgjidhen dhe katër përfaqësues nga sektori ekonomik privat. Përzgjedhja e katër anëtarëve të Bordit Drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, nga sektori ekonomik privat, bëhet sipas përcaktimit të Nenit 12, Pika 3 të ligjit 10303 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve" dt. 15.7.2010..
4. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues të zgjedhur nga sektori privat zgjat 4 vjet. Në mbarim të këtij afati, anëtari i Bordit Drejtues i zgjedhur nga sektori privat, mund të rizgjidhet perseri në përputhje me kriteret dhe procedurat e VKM-ne Nr. 758, datë 15.9.2010 "Për përcaktimin e procedurës dhe kriterëve për përzgjedhjen e Anëtarëve të Bordit Drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve(AIDA) nga sektori ekonomik privat dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të këtij bordi"
5. Mandati i Anëtarit të Bordit Drejtues të zgjedhur nga sektori privat mbaron përpara afatit nëse;
- jep dorëheqjen;
 - krijohen kushte të papajtueshmërisë apo të konfliktit të interesit;
 - humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate;
 - nuk merr pjesë në të paktën gjysmën e mbledhjeve të Bordit, të organizuara gjatë një viti;
 - vdes;
 - dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykate të formës së prerë.
6. Bordi Drejtues shkarkon nga detyra anëtarin e Bordit të zgjedhur nga sektori privat, kur vëren shkelje të ligjit dhe të akteve të përgjithshme të Agjencisë, ose kur sjellja e qëndrimi i tij cenon autoritetin e Agjencisë.
7. Mbarimi i mandatit përpara afatit të një prej anëtarëve konstatohet me vendim të Bordit.
8. Emërimi i anëtarit të ri të Bordit Drejtues bëhet jo më vonë se 30 ditë nga data e mbarimit të mandatit apo shkarkimit të tij.
9. Mandati i anëtarit të ri të Bordit zgjat 4 vjet.

Neni 14

Kompetencat e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues ka këto kompetenca:

04

- a) përshtat politikat qeveritare në veprimtarinë e Agjencisë;
- b) propozon politika të reja, si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre prej Agjencisë;
- c) miraton statutin e Agjencisë dhe aktet më të rëndësishme për organizimin dhe funksionimin e saj;
- d) miraton programin financiar 3-vjeçar dhe vjetor të Agjencisë dhe ja dergon Ministrise përgjegjëse për ekonomine, për ta përfshirë në programin e saj buxhetor.
- e) miraton planet vjetore të biznesit, tarifat e shërbimit, planet e veprimit për zbatimin e strategjive, programin e veprimtarisë së Agjencisë për vitin financiar, si dhe kontrollon zbatimin e tyre;
- f) miraton dhe mbikëqyr zbatimin e strategjive 3-vjeçare për 1) nxitjen e investimeve, 2) zhvillimin e eksporteve dhe fuqizimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme si dhe 3) investimet për rinovimin dhe përmirësimin teknologjik të bizneseve;
- g) si pjesë përbërëse e strategjisë 3-vjeçare për nxitjen e investimeve, zhvillon dhe zbaton planin operacional të marketingut dhe të komunikimit i cili synon të forcojë imazhin e Shqipërisë si një vend i favorshëm për investimet dhe biznesin.
- h) mbikëqyr në vazhdimësi përmbushjen e detyrave nga Agjencia;
- i) emëron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv,
- j) miraton rregullat e hollësishme për kushtet dhe procedurat për shpërndarjen e fondeve, në përmbushje të objektivave të Agjencisë;
- k) miraton rregulloren e funksionimit të Agjencisë dhe kriteret bazë të punësimit të personelit;
- l) i paraqet çdo gjashtë muaj, Këshillit të Ministrave, një raport në lidhje me vështirësitë dhe pengesat të cilat vështirësojnë tërheqjen e investimeve të huaja, rritjen e eksporteve, konkurrencën e lirë dhe rinovimin e bizneseve, shoqëruar me rekomandimet për masat që duhen marrë për eliminimin e këtyre pengesave
- m) miraton rregulla për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe informacioneve të bizneseve private dhe investuesve të marra gjatë marrëdhënieve të këtyre bizneseve me Agjencinë.
- n) vendos për çështjet e tjera, të parashikuara në ligj ose në statut

Neni 15

Mbledhjet e Bordit Drejtues

Cf

Bordi Drejtues mblidhet, në mënyrë periodike, të paktën një herë në tre muaj ose sa herë që e kërkon interesi i Agjencisë.

Bordi Drejtues thirret nga Kryetari. Kryetari thërret mbledhjen e Bordit Drejtues edhe kur kjo gje kërkohet nga të paktën 3 anëtarë të Bordit Drejtues.

Thirrja e mbledhjes së Bordit Drejtues duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim, të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj.

Në njoftimin për mbledhje shënohen data, ora, vendi i zhvillimit të mbledhjes, rendi i ditës si dhe materialet mbështetëse, të cilat dërgohen e merren nga anëtarët e Bordit Drejtues në formë të shkruar apo elektronike. Kur ka nevojë, njoftimit i bashkëlidhen edhe projektvendimet, që parashikohen të shqyrtohen në mbledhje.

Bordi Drejtues do të mblidhet rregullisht, pavarësisht nga respektimi i këtyre formaliteteve, në rast se të gjithë anëtarët e tij bien dakord për rendin e ditës, kohën dhe vendin e takimit.

Mbledhjet e Bordit Drejtues, janë të vlefshme kur janë prezent me shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Kryetari drejton mbledhjet e Bordit Drejtues. Në rastet e mungesës së tij, mbledhja drejtohet nga Nënkryetari i Bordit Drejtues, ose në mungesë të tij nga një anëtar i caktuar nga Kryetari i Bordit Drejtues

Bordi Drejtues mblidhet në selinë e Agjencisë ose në vend tjetër të caktuar në njoftim.

Anëtarët, kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe informacioneve, objekt i njoftimit ose që diskutohen në mbledhje.

Kryetari i Bordit Drejtues cakton një sekretar, i cili mban regjistrin e prezencës së anëtarëve dhe përpilon procesverbalin e mbledhjes së Bordit Drejtues. Procesverbalet në fund të mbledhjes firmosen nga Kryetari dhe anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe depozitohen në Agjenci në një regjistër të posaçëm.

Vendimet e Bordit Drejtues, me përjashtim të pjesëve që përmbajnë informacion konfidencial apo të dhëna personale, si dhe njoftimet e organeve të Agjencisë publikohen në faqen e internetit të Agjencisë, qoftë dhe në mënyrë të përmbledhur, brenda 10 ditëve nga data e mbajtjes ose marrjes së tyre.

Neni 16

Vendimet e Bordit Drejtues

Vendimmarrja e Bordit bëhet me konsensus.

ef

Në rast se nuk arrihet konsensus, vendimet e Bordit Drejtues janë të vlefshme kur votojnë pro më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Përfundimisht, Statuti dhe ndryshimet e tij miratohen me unanimitetin e anëtarëve të Bordit Drejtues. Në mungesë të konsensusit unanim, vendimet në lidhje me statutin merren me votën pro të të paktën gjashtë prej anëtarëve të Bordit Drejtues.

Një anëtar i Bordit Drejtues mund ti delegojë një anëtar tjetër me anën e një autorizimi, përfaqësimin dhe votën e tij.

Çdo anëtar gëzon të drejtën e një vote dhe secila votë është e barabartë. Në rast barazimi votash, vota e Kryetarit të Bordit është vendimtare.

Vendimet e Bordit firmosen nga Kryetari i Bordit.

Neni 17

Kryetari i Bordit Drejtues

Kryetari i Bordit Drejtues thërret dhe drejton mbledhjet e këtij Bordi në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në këtë statut., Me propozon te Drejtorit Ekzekutiv, cakton rendin e ditës te mbledhjes se Bordit. Kryetari i propozon për miratim Bordit Drejtues strukturën dhe nivelin e pagave për punonjësit e Agjencisë.

Ai mbikëqyr dhe kontrollon realizimin e rregullt të veprimtarisë së Agjencisë, në përputhje me ligjin, këtë statut, planet vjetore, dokumentet e tjera politike të miratuara nga Bordi Drejtues, si dhe kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar nga ligji dhe ky statut.

Neni 18

Nënkryetari i Bordit Drejtues

Nënkryetari i Bordit Drejtues është ministri përgjegjës për ekonominë. Kryetari i Bordit Drejtues mund t'ia delegojë kompetencat e tij Nënkryetarit të Bordit Drejtues.

Në rastet kur mungon Kryetari i Bordit Drejtues, Nënkryetari i Bordit kryeson mbledhjet e Bordit Drejtues dhe e zëvendëson atë në ushtrimin e kompetencave të tij.

Neni 19

Pjesëmarrja në mbledhje e personave të tjerë

Në mbledhjet e Bordit Drejtues merr pjese Drejtori Ekzekutiv pa te drejte vote.

Kryetari mund të ftojë këshilltarë ose ekspertë të jashtëm, nëse kjo rezulton e nevojshme për veprimtaritë e Agjencisë

eg

Këshilltarët dhe ekspertët e ftuar marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.

Neni 20

Shpërblimi

Anëtarët e Bordit Drejtues gëzojnë të drejtën e shpërblimit për pjesëmarrjen në mbledhjet e tij.

Shpërblimi i anëtarëve të Bordit Drejtues bëhet në bazë të pjesëmarrjes në mbledhje dhe përballohet nga buxheti i Agjencisë.

Masa e shpërblimit të tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Anëtarët e Bordit Drejtues përfitojnë shpërblim vetëm për pjesëmarrje në mbledhjet e tij, si dhe rimbursim të shpenzimeve për shërbime, udhëtime e dieta, që lidhen me veprimtarinë e tyre, për zbatimin e veprimtarive të Agjencisë.

Neni 21

Drejtori Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Bordi Drejtues me propozim të ministrit përgjegjës për ekonominë, për një mandat 4-vjeçar me të drejtë riemërimi.

Ai lirohet nga detyra, para mbarimit të mandatit, nga Bordi Drejtues:

- me kërkesë të tij;
- për një nga shkaqet e parashikuar në nenin 13, paragrafi 5 të këtij statuti
- si dhe kur vihen re paaftësi në ushtrimin e detyrave të tij.

Emërimi i Drejtorit të ri Ekzekutiv nga ana e Bordit Drejtues, bëhet jo më vonë se 30 ditë nga data e mbarimit të mandatit apo shkarkimit të tij

Propozimin për shkarkim të Drejtorit Ekzekutiv mund ta paraqesë secili nga anëtarët e Bordit.

Neni 22

Tagrat e përfaqësimit

Agjencia, në marrëdhënie me të tretët, përfaqësohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe në mungesë të tij, nga njëri nga Drejtorët e Departamenteve të Agjencisë, në rastet kur autorizohet me shkrim nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 23

Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv ka këto kompetenca:

- a) drejton dhe administron veprimtarinë e përditshme të Agjencisë, në përputhje me ligjin nr.10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve", legjislacionin shqiptar në përgjithësi dhe me këtë statut, duke zbatuar vendimet e marra nga Bordi Drejtues;
- b) vepron në emër të Agjencisë në marrëdhëniet me palë të treta dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë;
- c) drejton veprimtarinë e personelit të Agjencisë, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e Agjencisë dhe rregullat e miratuara nga Bordi Drejtues;
- d) organizon e bashkërendon punën ndërmjet njësive të Agjencisë;
- e) nxjerr urdhëra dhe udhëzime të brendshme të detyrueshme për administrimin administrativ dhe financiar të institucionit;
- f) harton rregulloren e brendshme të veprimtarisë së Agjencisë dhe ia paraqet për miratim Bordit Drejtues;
- g) harton dhe i paraqet për miratim Bordit Drejtues, dokumentet financiare dhe programin vjetor të punës së Agjencisë;
- h) përgjigjet për shpenzimet e bëra nga buxheti i Agjencisë në përputhje me objektivat, qëllimin dhe funksionimin e Agjencisë;
- i) raporton, të paktën, katër herë në vit, para Bordit Drejtues për veprimtarinë e Agjencisë. Me kërkesë të secilit prej anëtarëve të Bordit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv raporton përpara Bordit edhe për çështje specifike, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e përditshme të Agjencisë;
- j) bashkërendon punën me Bordin për zbatimin, me sukses, të strategjisë së qeverisë për nxitjen e biznesit dhe të investimeve;
- k) bashkëpunon me donatorë, vendas dhe të huaj, për sigurimin e fondeve të Agjencisë, si dhe bën menaxhimin e tyre;
- l) krijon dhe zhvillon lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të organizatave të biznesit dhe institucioneve publike, me qëllim realizimin e detyrave dhe të objektivave të Agjencisë, si dhe të përmirësimit, gjithnjë e më tepër, të imazhit pozitiv të Shqipërisë te partnerët e huaj;

ef

- m) garanton cilësinë e materialeve informuese e promovuese, të bëra nga Agjencia, dhe shpërndarjen në kohë të tyre, institucioneve, publike dhe private, të interesuara;
- n) i bën propozime dhe sugjerime Bordit Drejtues, në të mirë dhe interes të veprimtarisë së Agjencisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet, përfshirë planin financiar të veprimtarisë e shpenzimet financiare dhe siguron zbatimin e vendimeve të tij;
- o) ushtron çdo detyrë që nuk i është dhënë Bordit Drejtues apo ndonjë organi tjetër të Agjencisë sipas ligjit, legjisllacionit në fuqi dhe këtij statuti.

Neni 24

Konflikti i interesave

Kryetari, Anëtarët e Bordit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv dhe punonjësit e Agjencisë, në ushtrimin e detyrave dhe të funksioneve të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me statutin, janë të detyruar të veprojnë duke zbatuar rregullat e procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", si dhe në aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij. Në veçanti;

Anëtari i Bordit Drejtues ose i çdo organi tjetër të Agjencisë, përfshirë personelin e saj, nuk mund të votojë ose të marrë pjesë në vendimmarrje kur ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të legjisllacionit në fuqi.

Anëtari i Bordit Drejtues ose i çdo organi tjetër të Agjencisë janë të detyruar të deklarojnë konfliktin e interesit të kryetari i organit të cilit i përkasin të paktën para pjesëmarrjes në vendimmarrje ose votimit. Drejtori Ekzekutiv e bën deklarinimin pranë Bordit Drejtues.

Personeli i Agjencisë është i detyruar të bëjë deklarinimin me shkrim të konfliktit të interesave të tyre dhe/ose të të afërmeve të tyre me interesat e Agjencisë. Kjo deklaratë i dorëzohet Drejtorit Ekzekutiv, i cili merr masa që konflikti i interesave të parandalohet ose të shmanget. Nëse ka ndonjë ndryshim të situatës njoftohet përsëri jo më vonë se 15 ditë kalendarike pasi ka ndodhur ndryshimi.

Anëtarët e Bordit Drejtues njoftojnë lidhur me raste të konfliktit të interesave në mbledhjen më të parë të tij. Ata nuk mund të marrin pjesë në diskutime dhe vendime që kanë të bëjnë me persona apo organe me të cilat mund të ndodhen në konflikt interesi sipas legjisllacionit në fuqi.

Transaksionet me palë të treta ku një anëtar i Bordit Drejtues apo Drejtori Ekzekutiv kanë interes privat, mund të lejohen vetëm në rastet kur transaksioni ofron kushtet më të favorshme për Agjencinë, gjë e cila duhet dokumentuar dhe miratuar nga Bordi Drejtues me vendim.

Në rastet kur ekziston një konflikt interesi që pengon veprimtarinë normale të Agjencisë apo krijon problem për të, Drejtori Ekzekutiv mund t'i kërkojë anëtarit përkatës të personelit të Agjencisë ta zgjidhë këtë konflikt brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Në rast se konflikti

ef

nuk zgjidhet, Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të marrë masa për shmangien e konfliktit. Në rastet kur në këtë situatë ndodhet një anëtar i Bordit Drejtues, apo Drejtori Ekzekutiv, atëherë këtë kompetencë e ka Bordi Drejtues.

KREU IV

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 25

Administrata e Agjencisë

Administrata e Agjencisë drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv.

Marrëdhëniet e punës të punonjësve të Agjencisë i nënshtrohen legjislacionit shqiptar të punës. Emërimi i punonjësve të Agjencisë kryhet në bazë të procedurave konkurruese, të miratuara nga Bordi Drejtues.

Drejtori Ekzekutiv përzgjedh, për çdo vend pune në Agjenci, një nga tre kandidaturat më të mira të dala nga procesi i konkurrimit.

Organizimi dhe funksionimi i personelit të Agjencisë rregullohen sipas rregullores së brendshme të Agjencisë, që miratohet nga Bordi Drejtues.

Nivelet e pagës dhe të shpërblimeve të punonjësve të Agjencisë miratohen nga Bordi Drejtues, në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi për pagat për administratën publike.

Nëpunësit e Agjencisë i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në përputhje me dispozitat e ligjit, legjislacionin në fuqi, këtë statut dhe aktet e tjera të përgjithshme të Agjencisë.

Dispozitat e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare për sekretin e veprimtarisë tregtare janë të zbatueshme për të gjithë nëpunësit e Agjencisë.

Neni 26

Struktura dhe organika e Agjencisë

Agjencia strukturohet në katër departamente të brendshëm: Departamenti i Investimeve të Huaja, Departamenti i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Zhvillimit të Eksporteve, Departamenti i Inovacionit dhe Departamenti i Marketingut dhe Financës.

Struktura e punonjësve të administratës së Agjencisë është sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij statuti.

Departamentet drejtohen nga Drejtorët e Departamenteve, të cilët zgjidhen nga Drejtori Ekzekutiv. Drejtori Ekzekutiv merr miratimin e Bordit Drejtues për emerimin e Drejtoreve të Departamenteve.

Departamentet zbatojnë objektivat dhe strategjitë specifike të Agjencisë dhe kur është e nevojshme koordinojnë veprimtaritë e tyre. Drejtorët e Departamenteve i raportojnë rregullisht Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë mbi aktivitetin dhe problematikat e hasura dhe propozojnë masat e nevojshme për sektorët përkatës.

Kompetencat dhe rregullat e brendshme të funksionimit të tyre përcaktohen në Rregulloren e brendshme të strukturës së Agjencisë, e cila miratohet nga Bordi Drejtues.

KREU V

FINANCIMI

Neni 27

Burimet e financimit

Në përputhje me nenin 3 të ligjit nr.10303, datë 15.7.2010, burimet e financimit të Agjencisë vijnë nga Buxheti i Shtetit, si një nënprogram i veçantë në buxhetin e ministrisë që mbulon ekonominë, të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj dhe donacionet.

Agjencia, në përputhje me ligjin, ka të drejtë të ofrojë shërbime dhe të realizojë të ardhura, në funksion të qëllimit e të veprimtarisë së saj.

Financimet, që Agjencia merr nga burimet e ndryshme, përdoren vetëm për kryerjen e veprimtarisë, sipas objektit që ka, në përputhje me rregullat e përcaktuara për institucionet buxhetore.

Neni 28

Buxheti i Agjencisë

Buxheti i Agjencisë mbulon pagat e administratës, veprimtaritë operative, aktivitete promovuese dhe shpenzimet e tjera.

Agjencia, në përputhje me legjislacionin në fuqi, vendos tarifa për shërbimet që ofron, duke përfshirë por pa u kufizuar në to: regjistrimin në regjistrin tregtar të bizneseve të huaja, asistencën në marrjen e lejeve, licencave apo autorizimeve, vlerësimet e ndikimit në mjedis, ekspertiza dhe shërbimet e logjistikës, etj. Tarifat e mbledhura hyjnë në buxhetin e Agjencisë dhe përdoren vetëm për qëllimin e realizimit të objektivave të veprimtarisë të caktuara nga ligji dhe ky statut.

cg

Projekt-buxheti vjetor përgatitet nga Departamenti i Marketingut dhe Financës, së bashku me Projekt-buxhetin 3-vjeçar, të cilët kontrollohen nga Drejtori Ekzekutiv dhe i paraqiten për miratim Bordit Drejtues.

Neni 29

Viti financiar

Viti financiar i Agjencisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor. Për çdo vit financiar hartohet bilanci ekonomiko-financiar, i cili vlerësohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Drejtori Ekzekutiv, brenda datës 30 Prill të çdo viti, i paraqet Bordit Drejtues bilancin e vitit financiar paraardhës, për shqyrtim dhe miratim.

Neni 30

Auditimi

Bordi Drejtues, sipas legjislacionit në fuqi, kërkon auditimin nëpërmjet kontrollit të brendshëm, si dhe cakton ekspertë kontabël të autorizuar për të ushtruar auditimin e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Agjencisë, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.

CH

NR.PROT.832
DATE 1.3.2011

MINISTRISË SË BRENDSHME
AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË
INVESTIMEVE
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE

Gjergj LEZHJA
Sekretari i Përgjithshëm

